



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 17.7.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË,
PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “RIFINANCIMI I
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT URBANE DHE
RURALE, FAZA E DYTË”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.86/2015**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 17 korrik 2018, shqyrtoi projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Ai shqyrtohet bazuar në nenin 121 të Kushtetutës dhe sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm, për të paraqitur dhe për të dhënë sqarime mbi projektligjin, Zëvendësministri i Financave dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Ligji bazë nr.86, datë 23.7.2015.

Marrëveshja e ratifikuar me këtë ligj parashikon financimin nga KFW të një huaje me kushte të favorshme prej 10 milionë eurosh, për financimin e projektit “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”. Kjo hua u jepet bankave të nivelit të dytë për

të mbështetur me kredi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale. Në marrëveshje vendoset kushti që projekti i parashikuar prej saj të mos zëvendësohet me projekte të tjera.

Ky ligj nuk u zbatua për arsye se, siç u evidentua nga sektori bankar dhe, më pas, një studim i kryer nga KFW, në bashkëpunim me Ministrinë për Zhvillimin Ekonomik, Tregtinë dhe Sipërmarrjet, bankat e nivelit të dytë kanë gjendje të mirë likuiditeti. Pengesa kryesore në dhënien e kredive nuk është mungesa e mjeteve financiare të këtyre bankave, por mungesa e garancive të huamarrësve për kthimin e kredive.

Me propozim të bankave të nivelit të dytë, palët ranë dakord për përdorimin e një instrumenti tjetër për promovimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Por, për arsye se ligji nr.86/2015 nuk lejon zëvendësimin e projektit objekt i tij me projekte të tjera, lindi nevoja për hartimin e një projektligji për denoncimin e marrëveshjes së ratifikuar me këtë ligj dhe më pas, hartimin e një projektligji të ri për mbështetjen e SME-ve. Projekti i ri do të realizojë mbështetje për SME-të nëpërmjet fondit të garancisë së kredive rurale, duke marrë një shumë financimi nga KFW prej 5 milionë eurosh.

Përmbajtja e projektligjit.

Projektligji parashikon denoncimin e marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr.86/2015. Praktika e denoncimit të marrëveshjeve ndërkombëtare mbështetet në nenin 121 të Kushtetutës dhe ligjin nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë“. Nëpërmjet aktit të denoncimit, Republika e Shqipërisë tërhiqet nga një marrëveshje ndërkombëtare. Denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi për marrëveshjet e ratifikuara prej tij.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, nga deputetët u kërkuar një informacion më i zgjeruar dhe u diskutua mbi marrëveshjen bazë, të ratifikuar me ligjin nr.86/2015. Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave informuan Komisionin se me zhvillimet që ndodhën në tregun financiar dhe thellimin e punës për reduktimin e kredive me probleme, instrumenti financiar i parashikuar në marrëveshjen bazë nuk mund të zbatohet. Arsyeja ishte se sektori bankar kishte gjendje likuiditeti për të kredituar SME-të, por këto të fundit nuk plotësonin kriteret e sektorit bankar për kolateral, duke mos garantuar kthimin e kredive. Për këtë arsye, pas analizës dhe studimit të tregut, nga sistemi bankar dhe KFW, u ra dakord që të përdorej një instrument i ri financiar, më eficient, për mbështetjen dhe kreditimin e SME-ve, nëpërmjet krijimit të Fondit të Garancisë së Kredive Rurale. Ky instrument i ri do të ndihmojë në rritjen e kapaciteteve të SME-ve për të pasur akses në kreditim.

Vlerësimi për projektligjin.

Komisioni është i mendimit se projektligji është i domosdoshëm, pasi parashikon tërheqjen nga një marrëveshje ndërkombëtare e pazbatueshme, duke i hapur rrugën një marrëveshjeje të re më eficiente. Qeveria gjermane dhe ajo shqiptare kanë rënë dakord që promovimi dhe mbështetja e SME-ve në zonat urbane dhe rurale të realizohet nëpërmjet një projekti të ri, që mbështetet në fondin e garancisë së kredive rurale dhe që do të realizohet nëpërmjet hartimit të një marrëveshjeje të re ndërkombëtare. Krijimi i këtij Fondi do të bëjë të mundur jo vetëm sigurimin e mbështetjes financiare për SME-të, por edhe dhënien e garancive në kthimin e kredive, duke parandaluar krijimin e kredive të reja me probleme, që është edhe një ndër rekomandimet kryesore të Fondit

Monetar Ndërkombëtar.

Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin me shumicë votash.

RELATORJA

Evis KUSHI

KRYETARI

Erion BRAÇE